

SYLLABUS 12

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Menaxhment Programi: Menaxhimi i Ndërmarrësisë dhe Inovacionit
Titulli i lëndës:	Menaxhimi i Inovacionit dhe Teknologjisë
Niveli:	Master
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Semestri:	II
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi:	4
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda Menaxhimi i Inovacionit dhe Teknologjisëshqyrton konceptet dhe përkufizimet bazë të Teknologjisë, Shpikjes, Kreativitetit dhe Inovacionit me theks në Inovacionin Teknologjik.</p> <p>Lënda përmban një perspektive historike, sociale dhe teknokratike të Inovacionit, me një referencë të shkurtër në procesin e Matësit të Inovacionit si dhe analizën dhe rolin e Dijes në Inovacion. Paraqet dallimi ndërmjet Inovacionit dhe Shpikjes duke renditur llojet dhe karakteristikat e Inovacionit të Thjeshtë dhe Inovacionit Teknologjik. Po ashtu përmes rasteve të detajuara të studimit shtjellohet marrëdhënia midis Inovacionit dhe Konkurrueshmërisë. Po ashtu lënda përmban llojet e inovacioneve dhe konfigurimi i sistemeve të inovacionit me përdorimin e Systems Dynamics, Menaxhimi dhe Transferimi i Teknologjisë si dhe Mekanizmat dhe modelet e Transferimit të Teknologjisë, pengesat dhe faktorët lehtësues për transferimin e suksesshëm të teknologjisë.</p>
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e lëndës janë që studentet të njihen me konceptet dhe përkufizimet e Teknologjisë, Shpikjes, Kreativitetit dhe Inovacionit Teknologjik, të njohin rolin e Dijes në Inovacion, të kuptojnë llojet e inovacionit të thjeshtë dhe teknologjik, si dhe mekanizmat dhe modelet e transferimit të teknologjisë.
Rezultatet e pritura të mësimnxënies:	<p>Në fund të kësaj lënde, studenti do të jetë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shpjegon konceptet e inovacionit të thjeshtë dhe teknologjik. 2. Analizo rolin e dijës në inovacion 3. Kupton konfigurimin e sistemeve të inovacionit me përdorimin e System Dynamics si dhe 4. Përzgjedh mekanizmat dhe modelet e transferimit të teknologjisë. 5. Kupto sfidat e menaxhimit teknologjik 6. Analizo dhe diskuton raste studimore 7. Interpreton modelet e procesit të inovacionit 8. Analizon lidhshmërinë e sipërmartjes me inovacionin

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren			
Kolloquium – seminar	1	5	5
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare në provim	5	1	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Projektet, prezantimet etj	1	5	5
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies (dhe mësimnxënies)	Ligjërata, ushtrime - punime seminarike, vlerësime, diskutime, vizita praktike ne ndërmarrje.		
Metodat e vlerësimit (kriteret e kalueshmërisë)	<p>Vlerësimi dhe forma e ndërtimit të notës për studentet do të mbështetet në aktivitetet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> Aktiviteti dhe angazhimi në mësim – vlerësohet me 20 pikë nga 100 pikët e mundshme, Aktiviteti ne mësim - nënkupton që studenti te jetë aktive dhe i përfshirë ne diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema te reja qe janë te ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim te nxitjes se debatit gjate ligjëratave. Angazhimi - nënkupton qe studenti ti kryej dhe prezantoj detyrat qe caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjëratës vijuese. Hartimi dhe prezantimi i një detyre, projekti/punimi seminarik, vlerësohet me 10 pikë nga 100 pikët e mundshme, Brenda semestrit studenti (mund te jete një grup i studenteve – jo me shume se 3 studente) duhet te përgatit një detyre, projekt/punim seminarik (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Tema e punimit mund te propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet te miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet te jete ne korrelacion te plote me lenden. Testi i provimit final, vlerësohet me 70 pikë nga 100 pikët e mundshme, Studenti do t'i nënshtrohet testit te provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe organizohet në afatet e provimeve, të përcaktuar nga senati i Universitetit. 		

	<p>Qëllimi i provimit është që të vlerësohet njohuria, aftësia, shkathtësia dhe kompetencat e studentit, ndërlidhur me rezultatet e mësimnxënies së parapare për materialin e lëndës së ligjësuar.</p> <p>Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> • pyetje objektive, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të rikujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës, • pyetje subjektive të llojit ese/detyrë me shkrim për të cilat vetë studenti duhet të jetë në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjësuar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë dhe vlerësim të problemit. <p>Studentët pasi i nënshtrohen provimit, do të ndërtojnë notën përfundimtare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • max 20 pikë - aktiviteti dhe angazhimi në mësim, • max 10 pikë - hartimi dhe prezantimi i detyrës, projektit, punimi/hulumtimit, • max 70 pikë - provimi final <p>Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë nga të gjitha kriteret e vlerësimit,</p>
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, etj.
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	70% Teori, 30% Ushtrime,
Literatura	
Literatura bazë	1. Innovation, Technology, and Knowledge Management, Elias G. Carayannis Elpida T. Samara Yannis L. Bakouros 2015.
Literatura shtesë	1. Carayannis EG, Formica P, (2008). Knowledge matters: technology, innovation and entrepreneurship in innovation networks and knowledge clusters.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	
	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Prezantimi – njoftimi i studenteve me syllabusin e lëndës, Hyrje në menaxhimin e teknologjive në inovacion. Duke ofruar konceptet dhe përkufizimet bazë të Teknologjisë, Shpikjes, Kreativitetit dhe Inovacionit me theks në Inovacionin Teknologjik. Rezultati i pritur nr.1
Java e dytë	Perspektiva historike mbi inovacionin Perspektiva historike, sociale dhe teknokratike e Inovacionit, me një referencë të shkurtër në procesin e Matësit të Inovacionit. Rezultati i pritur nr.1
Java e tretë	Menaxhimi i Inovacionit

	Kryesisht përmes Arsimit dhe Menaxhimit të Dijes. Për më tepër, është analizuar roli i Dijes në Inovacion dhe marrëdhënia ndërmjet Dijes dhe Mësimimit dhe është paraqitur modeli i Procesit të Njohurisë. Rezultati i pritur nr.2
Java e katërt	Dallimi ndërmjet Inovacionit dhe Shpikjes Këtu janë renditur llojet dhe karakteristikat e Inovacionit të Thjeshtë dhe Inovacionit Teknologjik. Rezultati i pritur nr.2
Java e pestë	Rast studimi Përmes një rasti të detajuar studimi të një kompanie të madhe, shtjellohet marrëdhënia midis Inovacionit dhe Konkurrueshmërisë. Këtu shtjellohen gjithashtu konceptet e Kreativitetit, Inovacionit dhe Konkurrueshmërisë në Sektorët Publik dhe Privat dhe analizohet roli i Sektorit Publik në promovimin e këtyre koncepteve. Rezultati i pritur nr.6
Java e gjashtë	Sfidat e menaxhimit teknologjik Menaxhimi i Inovacionit Teknologjik dhe sfidat pasuese është subjekt i këtij kapitullit, një çështje e paraqitur edhe përmes rasteve studimore. Rezultati i pritur nr.5
Java e shtatë	Kuptimi i modeleve të procesit të inovacionit Ky kapitull rendit modelet e ndryshme standarde të Procesit të Inovacionit duke iu referuar (a) Menaxhimit të Drejtave të Pronësisë Intelektuale dhe (b) konceptit dhe praktikës së Menaxhimit të Dijes dhe Kapitalit Intelektual Rezultati i pritur nr.7
Java e tetë	Sistemet e Inovacionit. Theks i veçantë i kushtohet prezantimit të llojeve të ndryshme të Sistemeve të Inovacionit dhe parimeve të tyre bazë, Sistemeve të Hapur dhe të Mbyllur të Inovacionit si zgjedhje strategjike dhe sistemeve të simulimit. Rezultati i pritur nr.7
Java e nëntë	Konfigurimi i Sistemeve të Inovacionit Me përdorimin e Systems Dynamics dhe aplikimin e këtyre standardeve në Sistemet Sektoriale, Rajonale dhe veçanërisht Kombëtare të Inovacionit. Ky kapitull përfundon me analiza të mëtejshme të Sistemeve të Inovacionit të Hapur, Rrjetëve të Inovacionit, Shoqërive të Dijes, Bashkëpunimit Ndërkombëtar Kërkimor dhe Indekseve të Inovacionit Rezultati i pritur nr.3
Java e dhjetë	Sipërmarrja dhe marrëdhënia e saj me Inovacionin. Për më tepër, janë paraqitur llojet e ndryshme të Sipërmarrjes, e ndjekur nga një analizë e koncepteve të Sipërmarrjes së Qëndrueshme, modelit të Ciklit të Jetës së Mësimimit dhe Mësimimit Strategjik. Rezultati i pritur nr.8
Java e njëmbëdhjetë	Praktikat e Sipërmarrjes dhe Inovacionit, me fokus në procedura të tilla si Menaxhimi dhe Transferimi i Teknologjisë. Rezultati i pritur nr.4
Java e dymbëdhjetë	Mekanizmat dhe modelet e Transferimit të Teknologjisë, Pengesat dhe faktorët lehtësues për transferimin e suksesshëm të teknologjisë.

		Rezultati i pritur nr.4
	Java e trembëdhjetë	Vizita praktike ne ndërmarrjet ku universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi
	Java e katërbëdhjetë	Inkubatorët e biznesit Është bërë gjithashtu një referencë për Inkubatorët e Biznesit dhe Grupimet e Teknologjisë kundrejt grupimeve të njohurive. Rezultati i pritur nr. 8
	Java e pesëmbëdhjetë	Prezantimet e punimeve nga studentet
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:		
<p>Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësuesi ka të drejtë t'i kërkojë studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.</p>		